



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

## KRYETARI

Nr. 1190/13Prot.

Tiranë, më 30 /04/2017

### V E N D I M

**Nr. 49, Datë 30.04.2017**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË**  
**MINISTRINË E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE**  
**ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË**  
**DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, dhe vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Përgjithshëm si dhe duke vlerësuar rëndësinë që ka një zhvillim i kujdesshëm dhe i vazhdueshëm në fushën e zhvillimit të bujqësisë në vend, rëndësi që nuk lidhet vetëm me hartimin e strategjive sektoriale por dhe me zbatimin konkret të tyre, transparencën dhe shpenzimin me efektivitetin të fondeve buxhetore që shkojnë në përmbushje të objektivave strategjik, për sa kohë fondet e këtij sektori zënë një peshë të konsiderueshme të fondeve buxhetore, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”,

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën 01.01.2014 – 31.12.2016 të ushtruar Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## **A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PERMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.**

Nga auditimi me zgjedhje të disa garave të zhvilluara për dhënien me qira të tokave bujqësore në administrim të MBZHRAU, konstatuam se ka aspekte të pa mbuluara mirë nga korniza ligjore që rregullon këtë proces. Konstatuam se deri më 31.12.2016 janë zhvilluar 31 procedura, mbi bazë të të cilave janë lidhur dhe janë në fuqi 26 kontrata, 2 kontrata janë zgjidhur si dhe lidhja e një kontrate është pezulluar, ndërkohë që dy procedura janë anuluar, për mos përmbushjeve të kushteve të përcaktuara në VKM-në nr.460, datë 22.05.2013. Disa nga problematikat që shoqërojnë këtë proces janë:

-Tokat shtetërore të përcaktuara për qiradhënie nga MBZHRAU, nuk janë të njohura publikisht sepse nuk janë të shpallura në ndonjë faqe kontakti të ministrisë në cilësinë e autoritetit qiradhënës, si dhe nuk ka një përcaktim të gjendjes së territorit të tokave.

-Nuk janë të përcaktuara prioritetet e autoritetit qiradhënës për zhvillimin e aktiviteteve në këto toka, për këtë arsye, shumë kërkues potencialë për marrje toke me qira, nuk e kanë të mundur që të dine vendndodhjen e tokave objekt qiradhënie e aq më shumë për cilësitë dhe përshatshmërinë e tyre në lidhje me një ose disa aktivitete bujqësore të caktuara.

-Në garat konkurruese të dhënies së këtyre tokave, konstatohen plan biznese të cilat janë paraqitur në garë nga fituesi por që nuk shoqërohen me dokumentim të aftësive financiare të fituesit për të garantuar projektet mbi të cilat konkurrohen (mungojnë dokumente ligjore vërtetues, nga bankat në rastet e kredive apo burimi i financimit mbi të cilin do të operohet).

-Përgatitja e plan bizneseve dhe sidomos projekti i ndikimit në mjedis nuk janë të hartuara nga persona të licensuar në fushën e mjedisit mangësi që konstatohet në të gjitha kontratat.

Transparenca e munguar sjell edhe garë të kufizuar në projektet që mund të zhvillohen në referencë të karakteristikave të sipërfaqeve të ofruara por dhe strategjive shtetërore të zhvillimit të rajoneve respektive.

Konstatohet se edhe kur autoriteti qiradhënës ka bërë njoftim publik, sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6 të kreut IV të VKM nr.460, ofertat kanë qenë ose të kufizuara ose me mangësi të theksuara në dokumentacion, *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 93-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- MBZHRAU si Autoriteti qiradhënës për dhënien me qira të tokave bujqësore, në pronësi të shtetit, ti propozojë Këshillit të Ministrave, ndryshimin e Ligjit nr. 8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar, VKM nr.45, datë 29.01.2014 “Për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, VKM nr. 460, datë 22.05.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, në të cilët të reflektohen të gjitha mangësitë e theksuara më sipër. Kërkojmë që përmirësimi ligjor të shoqërohet me miratimin e listës së pasurive që përbëjnë fondin e tokës me sipërfaqe prej 18076 ha që ka kaluar në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

- Të procedohet në çdo rast, së pari, me verifikimet e pretendimeve të ish-pronarëve, përpara dhënies së tokave me qera që administron Ministria, duke respektuar të drejtën e pronës, për pronarët e ligjshëm. Për tokat të cilat ka pretendime të ish-pronarëve të tyre, në asnjë rast, mos të japi këto toka me qera, pa u zgjidhur më parë konflikti ligjor, duke eliminuar kështu kostot shtese, financiare dhe sociale.

- Për çdo vit MBZHRAU të hartojë listën e sipërfaqeve/parcelave që do të jepen me qira, vendodhjen si dhe strategjinë e zhvillimit rajonal të zonës në të cilën ndodhen këto toka, e gjithë

kjo nëpërmjet një procesi të formalizuar qarte dhe në fokusin e një transparence të plotë, për të gjitha palët e interesuara, ku vëmendje të posaçme duhet ti jepet pretendimeve të ish-pronarëve, përpara hapjes së procedurave të qiradhënies.

*Menjëherë*

## **B. MASA ORGANIZATIVE.**

1. Nga auditimi për dhënien me qira të tokës bujqësore, konstatohet se MBZHRAU nuk ka një Strategji konkrete të zhvillimit të tokave që administrohen prej saj, mungesë që vjen edhe për shkak se Ministria nuk ka një hartë të ndërtuar kadastrale dhe vizuale ose digitale e cila të jetë transparente për publikun dhe investitorët e mundshëm. Procedura e dhënies me qira të fondit të tokave nën administrim nuk reflekton objektivat e një plani zhvillimi sektorial bujqësor sipas zonave, por mjaftohet me kërkesa individuale të cilat nuk e bëjnë transparent procesin dhe cenojnë parimet e transparencës dhe barazisë për çdo investitor dhe palë të interesuar, *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 93-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- MBZHRAU të ndërtojë një hartë kadastrale dhe vizuale e cila të bëhet transparente për publikun dhe investitorët e mundshëm. Mbi këto të dhëna të hartojë një Strategji konkrete të zhvillimit të tokave që administrohen prej saj si dhe të hartojë dhe paraqesin një plan zhvillimi sektorial bujqësor sipas zonave, duke e bërë transparent procesin e zhvillimit të tyre duke mos cenuar parimet e transparencës dhe barazisë për çdo investitor dhe palë të interesuar.

*Menjëherë*

2. Nga ana e MBZHRAU-s në asnjë rast nuk është kryer monitorimi i 26 kontratave të dhëna me qira, mbi realizimin e investimit që pretendohet të kryhej nga qiramarrësi, përdorimi i tyre, punësimi i pretenduar etj, në kundërshtim kjo me kërkesat e VKM nr.460, datë 22.05.2013 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” ku “*drejtoria përgjegjëse për administrimin e pronave publike në Ministri, monitoron zbatimin e kontratave të qerasë nga qiramarrësit si dhe ... merr raportime periodike apo kontrollon drejtorinë rajonale të bujqësisë për monitorimet e kryera nga kjo drejtori për zbatimin e kontratës së qerasë.*” Konstatohet se MBZHRAU nuk ka një njësi monitorimi dhe nuk disponon informacion nga monitorimi në vend i këtyre kontratave mbi realizimin e investimit që pretendohet të kryhej nga qiramarrësi, përdorimi i tyre, punësimi i pretenduar etj, *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 93-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

MBZHRAU, të përcaktojë brenda strukturës së saj, një njësi monitorimi e cila të monitorojë në vazhdimësi kontratat e dhëna me qira, mbi realizimin e investimit që pretendohet të kryhej nga qiramarrësi, përdorimi i tyre, punësimi i pretenduar etj.

*Menjëherë*

3. Nga auditimi mbi zbatimin e ligjit nr.152/2013, datë 01.10.2013 “Për statusin e nëpunësit civil” në lidhje me respektimin e strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin, procedurat e ndjekura në rekrutimet për vende të lira pune, ngritjen në detyrë, lëvizjet paralele dhe administrimin e dosjeve të personelit rezultoi se:

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për periudhën objekt auditimi në strukturën organike, pavarësisht lëvizjeve paralele apo ngritjeve në detyrë, nuk ka plotësuar numrin e planifikuar të punonjësve, miratuar me urdhrin nr. 189, datë 18.10. 2013, si dhe urdhrin nr. 34, datë 12.03.2015, “*Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*” të Kryeministrit.

Në ecurinë e procesit të deklarimit të statusit të punësimit për nëpunësit civilë ekzistues, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, i ka gjetur në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, dhe duhet të kryenin procesin e deklarimit të statusit të punësimit në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, konstatohet se MBZHRAU ka dërguar materialet shkresore në që provojnë kryerjen e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit në DAP, por nga Departamenti i Administratës Publike deri në momentin e auditimit nuk është kthyer përgjigje, *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për periudhën objekt auditimi MBZHRAU ka ekzekutuar 17 vendime gjyqësore **me vlerë 25,128,567 lekë** për ish punonjësit, që kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna. Nga vendimet e ekzekutuara 2 i përkasin vitit 2014, vendime të cilat janë për rikthim në vendin e punës, 9 vendime i përkasin vitit 2015 dhe vitit 2016 i përkasin 3 vendime.

Për vitin 2014 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore 3,230,341 lekë, vlerë e cila është paguar nga fondi i akorduar nga MBZHRAU.

Për vitin 2015 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore është 14,758,740 lekë, vlerë e cil është paguar nga fondi i akorduar nga MBZHRAU.

Për vitin 2016 vlera në total për ekzekutim të vendimeve gjyqësore është 7,139,486 lekë, vlerë e cila është likuiduar nga fondi i akorduar nga MBZHRAU.

Për periudhën objekt auditimi MBZHRAU ka likuiduar 2 persona, punonjës të aparatit, të cilët kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna, me të drejtë rikthimi në vendin e punës, vendim i cili nuk është zbatuar nga ana e MBZHRAU. **Vlera e likuiduar në total, deri më 31.12.2016, për këta dy persona është 5,723,291 lekë,** e mbetur për tu likuiduar **vlera 1,058,000 lekë,** në kundërshtim me Vendimet e Gjykatave, duke mos i ekzekutuar ato në kundërshtim me pjesën 4 të Kodit të Procedurës civile, Ekzekutimi i Detyrueshëm, *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës së Lartë Publike të marrë masa për plotësimin e vendeve vakantë në strukturë si dhe të plotësojë me dokumentacionin e nevojshëm dosjet personale për nëpunësit e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues.

- Të merren masa dhe të nxirren përgjegjësitë konkrete ndaj personave shkaktar përgjegjës për detyrimet financiare të krijuara në dëm të buxhetit, si pasojë e vendimeve të gjykatave. Ndërkohë që Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masa për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish punonjësit e Ministrisë, me të drejtë rikthimi në vendin e punës, se pari , në respekt të zbatimit të Ligjit dhe të drejtës së nëpunësit civil, në mënyrë që të ndërpritet rritja e detyrimeve financiare në buxhetin e shtetit.

- Të gjitha detyrimet e krijuara sipas vendimeve të gjykatave të ekzekutohen në mënyrë vullnetare, pa urdhër ekzekutimi të përmbauesit, me qëllim eliminimin e pagesës së tarifës së shërbimit të përmbauesit.

- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, vazhdimisht, të ndjekë me kujdes, të gjitha shkallët e gjykimit, për të gjitha rastet e ankimimit, ndaj vendimit të titullarit dhe ish titullarëve të Ministrisë, për largim nga puna.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**5.** Nga auditimi i procedurave të përlllogaritjes së fondit limit nga AK, është konstatuar se përlllogaritja e fondit limit zakonisht është bërë bazuar në oferta nga operatorët ekonomik që zhvillojnë aktivitet në fushën përkatëse. Përdorimi vetëm i kësaj procedure për llogaritjen e fondit limit, pa një analize, në shumë raste nuk ka reflektuar çmimet e tregut, dhe kanë rezultuar në fonde limit të fryrë e të paargumentuar. Rasti më tipik i kësaj mangësie është tenderi i blerjes

së mëshqerrave, ku çmimi për njësi kokë (mëshqerrë), nuk i përgjigjet çmimeve të tregut të vendit, madje edhe vetë çmimeve për shitjet e bëra gjatë vitit 2016, nga OE “NF” shpk (i shpallur fitues i tenderit). Theksojmë se, në gjysmën e dytë të muajit dhjetor 2016, **janë zhvilluar me procedure negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës 9 tendera për blerje mallra, punë e shërbime, me vlerë rreth 525 milion lekë pa TVSH.**

Në tenderat për realizimin e aktiviteteve të muajve të bujqësisë shqiptare, janë grupuar mallra e shërbime pa karakteristika të përbashkëta dhe llogaritja e vlerës është bërë me të njëjtin çmim për njësi, si: blerje e materialeve promovuese postera, mjete me logo të ministrisë dhe aktiviteti, marrja me qira e makinave, ose biçikletave lëvizëse, city-light etj, me të njëjtin çmim njësi. Për disa mallra apo shërbime, çmimet për njësi nuk janë të argumentuar, si shpenzimet për ekspertët e verës (ekspert të huaj, pa përcaktuar nga cili vend do të jenë të ftuarit), shpenzime transporti e montimi, tarifa për marrjen me qira të ambienteve, pa përcaktuar kërkesat e AK, lidhur me kohen që do të mbahen me qira ambientet, apo bazën ligjore ku bazohet çmimi, etj.

Edhe në tenderin për blerjen e motoçikletave etj, përdorimi i metodës së përlllogaritjes së fondit limit, duke marrë oferta nga operatorë ekonomik që ushtrojnë aktivitet në fushën e objektit të prokurimit, pa bërë një analizë të çmimit, nuk ka qenë i efektshëm dhe nuk ka pasqyruar çmimet reale të tregut, *më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Autoriteti Kontraktor nëpërmjet grupeve të punës ngritur për këtë qëllim, të përdorë alternativën apo kombinim alternativash, të parashikuara ligjore për llogaritjen e fondit limit, me synimin që çmimet t’i afrohen sa më tepër realitetit të tregut, ofertat të jenë sa më të besueshme, për të arritur qëllimin e prokurimit rritjen e efikasitetit të procedurave të konkurrimit dhe mire përdorimin e fondeve publike.

*Në vazhdimësi*

**6.** Në tenderat me objekt “Shpenzime mbrojtje bimësh & luftimi i parazitëve në bujqësi, luftimi i karkalecit e miut të arave”, zhvilluar në tre vitet periudhë auditimi, ku vetëm për vitin 2014, sipërfaqja e tokës që do të dezinfektohet është **7891 ha** e shpërndarë në 11 qarqe, vlera e fondit limit **22,358,683 lekë pa TVSH, për vitin 2015** sipërfaqja e infektuar **14466 ha**, e shtrirë në qarqet e vendit dhe fondi limit i llogaritur është 41,663,800 lekë pa TVSH. Për vitin 2016 sipërfaqja e përgjithshme e tokës, që do të dezinfektohet është **22583, 5 ha** dhe fondi limit i llogaritur është 44,979,870 lekë pa TVSH.

Konstatohet se në asnjë rast, grupet e punës nuk i janë referuar shkallës së infeksionit në ngastrat e tokave, ku do të bëhet dezinfektimi (infeksion i shkallës së lartë, të mesme etj). Kjo është e lidhur ngushtë me përcaktimin e sasisë të preparatit për njësi (ha) dhe me fondin limit të përlllogaritur për kryerjen e dezinfektimit, *më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Në çdo rast të prokurimit të shërbimeve për dezinfektimin e sipërfaqeve të infektuara, autoriteti kontraktor nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Bujqësisë, përpara hapjes së procedurave të përcaktojë duke dokumentuar profesionalisht, nivelin e infeksionit nga parazitët (karkaleci e miu i arave).

*Në vazhdimësi*

**7.** Në procedurat për prokurimin e shërbimit të mirëmbajtjes të sistemit BLU-BOX, është konstatuar se në dokumentet e tenderit dhe të ofertave, nuk është bërë ndarja e shpenzimeve në kosto operacionale dhe kosto mirëmbajtje. Ndarja në dy pjesë e shpenzimeve është e domosdoshme, pasi burimet e fondeve për mbulimin e tyre janë të ndryshme. Shpenzimet operacionale mbulohen nga subjektet private (anijet e peshkimit) ndërsa kosto e mirëmbajtjes të

sistemit BLU-BOX përballohet nga buxheti i shtetit (Nenet 71, 72 të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, pika 31 e VKM nr.407, datë 8.05.2013 “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim” i ndryshuar). **Kjo do të thotë se, me miratimin e bazës ligjore të mësipërme, Autoriteti Kontraktor padrejtësisht ka vazhduar të përballojë shpenzimet operacionale, të cilat çdo vit kanë zënë rreth 70 % e vlerës së përgjithshme të fondeve të planifikuara e të prokuruar për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit BLU-BOX ose 31.7 milion lekë pa tvsh për të tre vitet 2014-2016 . Ky veprim është i pajustificuar dhe i pambështetur në bazën ligjore.**

Në dokumentet për lidhjen e zbatimit e kontratave të shërbimit dhe mirëmbajtjes të sistemit BLU-BOX, ka rezultuar se periudha kohore nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e objektit të prokurimit, nuk ka qenë e njëjtë me periudhën e parashikuar në dokumentet e tenderit, lidhur me afatet e ekzekutimit të kontratës, për shkaqe të autoritetit kontraktor ose jashtë kontrollit të tij. Kohëzgjatja e shërbimit në kontratat e nënshkruara, ka qenë gjithnjë më e shkurtër se ajo e parashikuar në dokumentet e tenderit. Por, megjithëse është zvogëluar kohëzgjatja e shërbimit, fondi limit për rrjedhje dhe ai i kontraktuar, nuk kanë ndryshuar. Logjikisht zvogëlimi i afatit të kryerjes së shërbimit të mirëmbajtjes (sipas kontratës), do të thotë më pak shpenzime, prandaj duhet të ishte shoqëruar me uljen e vlerës së kontratës, sepse shërbimi është ofruar në një kohë më të shkurtër, duke u përfituar padrejtësisht shumat e mësipërme, *më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- MBZHRAU menjëherë të marrë masa për anijet e peshkimit, që ato të paguajnë në numrin e llogarisë të përcaktuar nga ministria, shumë vjetore të transmetimit satelitor apo mesazheve me sistemet e tjera. Gjithashtu, të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin e detyrimit nga subjektet private (anijet e peshkimit), për shpenzimet e shërbimeve operacionale, fonde që padrejtësisht janë mbuluar nga buxheti i shtetit.

- Për tenderat në vazhdim, me objekt shërbimit dhe mirëmbajtjes të sistemit BLU-BOX apo tenderat me këtë objekt të ngjashëm, ku shpenzimet varen nga kohëzgjatja e kontratës, autoriteti kontraktor të kërkojë në DT, që operatorët ekonomik të paraqesin ofertat e tyre bazuar në kostot mujore të kryerjes së shërbimit, **mbi të njëjtën bazë edhe autoriteti kontraktor të bëjë vlerësimin e ofertave.**

*Vazhdimisht*

**8.** Në tenderin me objekt blerje kafshë të llojit gjedh, për dëmshpërblimin e fermerëve të dëmtuar nga dermatosa nodulare e gjedhit, është nënshkruar kontrata e furnizimit me nr. prot 9742/2, date 28.12.2016, me vlerë 248,648,000 lekë pa TVSH dhe 298,368,000 lekë me TVSH. Në vlefte përfshihen detyrimet fiskale ndaj shtetit, transporti dhe dorëzimi në DB të qarqeve si dhe garancia sipas kushteve paraprake të vendosura në marrëveshjet e përbashkëta midis palëve. Malli do të lëvrohet në magazinën e AK, brenda 120 ditëve nga nënshkrimi i kontratës, shoqëruar me faturë tatimore shitje.

**Disa tregues të kërkuar në specifikimet teknike, për mëshqerrat që do të furnizohen nga kontraktatori, nuk mund të verifikohen deri në afatet e shtrirjes së kontratës (120 ditë kalendarike), por vetëm mbas një periudhe relativisht të gjatë (mbas pjelljes së mëshqerrave, marrjes së prodhimit të qumështit, yndyrës etj. për një periudhë relative të paktën për 1 vit), si:**

*-Prodhimi i qumështit në lakt. I-rë jo më pak se 4000 kg/305 ditë;*

*-Sasia vjetore e yndyrës të jetë jo më pak se 248 kg (5.5%)*

*-Sasia vjetore e proteinës të jetë jo më pak se 185 kg (4.1%)*

Për zbatimin e këtyre kushteve të autoritetit kontraktor, nuk është shprehur kontrata. Ky problem duhet rregulluar nëpërmjet amendimeve të kontratës, me marrëveshje midis palëve, *më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Duke qenë se, disa tregues të kërkuar në specifikimet teknike, për mëshqerrat që do të furnizohen nga kontraktori, nuk mund të verifikohen deri në afatet e shtrirjes së kontratës (120 ditë kalendarike), por vetëm mbas një periudhe relativisht të gjatë (mbas përfundimit të mëshqerrave, marrjes së prodhimit të qumështit, yndyrës etj. për një periudhë relative të paktën për 1 vit),
- Autoriteti Kontraktor në bashkëpunim me kontraktuesin të bëjnë amendimin e neneve të kontratës zgjatjen e afatit të saj, me qëllim verifikimin e detyrimeve të kontraktuesit lidhur me realizimin e treguesve të specifikimeve teknike.
- Auditimi i Brendshëm i MBZHRAU, në përfundim të kontratës të auditojë zbatimin e kushteve të saj dhe të gjitha detyrimet që ka pasur kontraktuesi.

*Menjëherë*

**9.** Nga auditimi i dokumenteve në dosjet e prokurimit, nuk rezulton që AK ka bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit, për t'u këshilluar për hartimin, përpara nënshkrimit të kontratave si dhe të kërkojë një opinion ligjor lidhur me problematikën dhe hapat që duhet të ndiqen në kontratën koncesionare me A. Këshillimi me Avokaturën e Shtetit, për kushtet dhe përmbajtjen e kontratave që nënshkruar autoritetit kontraktor me fituesit e procedurave të prokurimit, është kërkesë e domosdoshme dhe e detyrueshme e AK, e shprehur në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", neni 15, pika 3 dhe VKM nr. 392, datë 8.04.2009, Kreu VI, neni 26/1, neni 27/2, *më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Autoriteti Kontraktor të bashkëpunojë me Avokaturën e Shtetit, për t'u këshilluar për hartimin, përpara nënshkrimit të kontratave si dhe të kërkojë një opinion ligjor lidhur me hapat që duhet të ndiqen në kontratën koncesionare me A. Këshillimi me Avokaturën e Shtetit, për kushtet dhe përmbajtjen e kontratave që nënshkruar autoritetit kontraktor me fituesit e procedurave të prokurimit, është kërkesë e domosdoshme dhe e detyrueshme e AK, e shprehur në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", neni 15, pika 3 dhe VKM nr. 392, datë 8.04.2009, Kreu VI, neni 26/1, neni 27/2.

*Menjëherë*

**10.** Në objektet e zbatimit të investimeve kryesisht rehabilitimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit, është konstatuar se janë shtuar volume gjurmimesh të tokave të forta, pa u bazuar në një raport gjeologjik që shpreh praninë e këtyre formacioneve të forta, problematikë e konstatuar në objektet "Rehabilitimi i Kanalit VLF 1 - 2" dhe "Kanali Kryesor Ujitës Mat-Lezhë". Konstatuam edhe që çmimi për njësi i gjurmimit të këtyre formacioneve është relativisht i lartë, fakt që sjell prirjen për shtimin e këtyre votimeve nga ana e kontraktorëve.

Ndërkohë që është konstatuar se në disa objekte janë hequr volumet e betoneve për veshjen e kanaleve, për ti zëvendësuar ato me volume të tjera të cilat kanë një kosto jo të lartë. Përkatesisht në objektin "**Rehabilitimi i Kanalit Vjosë Levan Fier, pjesa e parë dhe e dytë**", gjatë zbatimit janë kryer punime jo efektive dhe të pa kërkuara në projekt-preventiv në një vlerë prej 7,702,731 lekë pa t.v.sh dhe 16,074,465 lekë pa t.v.sh të cilat nuk kanë ndryshuar kapacitetin e kanalit dhe përmirësuar gjendjen e tij. Gjithashtu në objektin "**Kanali Kryesor Ujitës Mat-Lezhë**", janë kryer punime jo efektive dhe të pa kërkuara në projekt-preventivin fillestar në një vlerë prej 8,615,560 lekë pa t.v.sh, të cilat nuk kanë ndryshuar kapacitetin e kanalit dhe përmirësuar gjendjen e tij, trajtuar më hollësisht në Projekt Raport, *më hollësisht është trajtuar në faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave gjatë hartimit të projekteve të kërkojë nga projektuesit që dosja e projektit të përmbajë në brendësi të tij, një raport gjeologjik i cili të përshkojë formacionet përbërëse në gjithë gjatësinë e objektit të projektuar. Gjithashtu Autoriteti Kontraktor, gjatë zbatimit të objekteve të mos pranojë asnjë ndryshim kategorie formacionesh gjeologjike, pa patur bashkëngjitur një raport gjeologjik të sigluar nga një gjeolog i licencuar.

- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave gjatë zbatimit të objekteve, në mënyrë kategorike të mos lejojë ndryshimin e projektit të hedhur në prokurim, duke hequr volume të veshjes së betonit ose volume për ndërtimin e urave B/A. Këto ndryshime të kryhen vetëm me miratimin e projektuesit dhe të jenë të shoqëruara me llogaritje hidraulike të sakta.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**11.** Në datë 6 mars u bë verifikimi në terren i realizimit të objektit “**Rehabilitimi i rrjetit të kanalit ujites të rezervuarit Shishtavec**”. U konstatua se në pjesë të ndryshime të objektit, ishin ribërë për së dyti punimet e veshjes me beton të kanaleve anësorë. Gjithashtu meqenëse terreni ishte i vështirë dhe një pjesë e objektit ishte i mbuluar me dëborë, nuk verifikohej rrjedhshmëria e ujit dhe furnizimi me ujë i zonës së poshtme të Shishtavecit *më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Për këtë Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës nga Drejtoria e Ujitjes së Kullimit, për të verifikuar funksionalitetin nga ana hidraulike e rrjetit të kanalit ujites. Gjithashtu të bëhet plotësimi dhe zbatimi i projektit në vazhdim në mënyrë që të mbyllet cikli i furnizimit me ujë i tokave të zonës së Shishtavecit.

*Menjëherë*

**12.** Në dokumentet standarde të tenderit në objektin “**Rehabilitimi i rrjetit të kanalit ujites të rezervuarit Shishtavec**”, nga Njësia e Prokurimit janë vendosur kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me makineritë, ku është specifikuar dokumentacioni i nevojshëm që duhet të posedojnë mjetet, ku është përcaktuar “*Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me anë të aktit të pronësisë. Ato të marra me qira të shoqërohen me kontratë qiraje (ose forme tjetër huaje) si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve. Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, certifikate e kontrollit teknik, policen e sigurimit të mjeteve*”, por nuk janë kërkuar taksat vjetore të automjeteve, megjithëse është kërkuar certifikata e kontrollit teknik, leja e qarkullimit dhe policia e sigurimit.

Kemi konstatuar parregullsi edhe përsa i përket vendosjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit nga ana e njësive së prokurimi në lidhje me kapacitetin teknik, punë të ngjashme, ku ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm vetëm për punët e realizuara për institucione shtetërore, por nuk është specifikuar dokumentacioni që duhet të posedojnë ofertuesit kur paraqesin një punë të ngjashme të realizuar për llogari të subjekteve privat, në mënyrë që mos të bëhet shkak për interpretime nga ana e ofertueseve, *më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Njësia e prokurimit të specifikojë të gjithë dokumentacionin që nevojitet për të vërtetuar realizimin me sukses të punëve të ngjashme kur ato janë realizuar për llogari të subjekteve private, sipas paragrafit të tretë, pika 6 të Nenit 26 “Kontratat për punë publike” të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



- Njësia e prokurimit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në lidhje me dokumentacionin e mjeteve, të kërkojnë të gjitha dokumentet dhe taksat vjetore dhe bashkiake, të cilat nevojiten për qarkullim mjeteve në territorin e Shqipërisë, në mënyrë që mos të bëhet arsye për interpretime nga ana e komisioneve të vlerësimit të ofertave gjatë procedurave të vlerësimit.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**13.** Nga auditimi i ushtruar konstatohet se, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, për periudhën objekt auditimi ka audituar aparatit si dhe njësitë e vartësisë të MBZHRAU. Në Programin Vjetor të Auditimit të vitit 2015, të miratuar nga Ministri me shkresën nr. 6899/1, prot, datë 10.10.2014, ka **parashikuar të realizojë gjithsej 25 misione auditimi dhe ka realizuar në fakt 31 misione ose 124 %**. Gjatë vitit 2015 nuk janë kryer tre auditime: Misioni i auditimit mbi projektin IPA- 2013, Implementimi i dy projekteve për fuqizimin e laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe për furnizimin e sektorit të blegtorisë, Bordi i Kullimit Elbasan, Agjencia e Peshkimit, *më hollësisht është trajtuar në pikën III faqet 212-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në bazë të auditimeve që kryen tek njësitë vartëse, ti fokusojë planet e auditimeve në bazë të subjekteve me më shumë risk duke përfshirë në auditim dhe veprimtarinë ekonomiko financiare të aparatit të ministrisë, duke ndërtuar një regjistër të subjekteve që kanë më shumë shkelje për orientimin e planit të auditimeve, në mënyrë që të evidentohen në kohë problematikat.

- Gjetjet e Auditimit të Brendshëm të shqyrtohen me seriozitetin e duhur nga të gjithë drejtoritë që janë përgjegjës për mbarëvajtjen e proceseve të punës në institucion dhe të përdoren për të evidentuar pikat e dobëta të institucionit.

-Të forcohet kontrolli i brendshëm në strukturat bazë, sikurse janë Drejtoritë e Bujqësisë si dhe Bordet e Kullimit, të rritet efektiviteti i kontroleve të kryera, të përmirësohet raporti i auditimeve në favor të atyre me bazë të lartë risku, të bëhet identifikimi në kohë i riskut si dhe të arkivohen dosjet brenda afateve pas përfundimit të auditimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për arkivat*" dhe manualit të auditimit.

*Në vazhdimësi*

**14.** Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", germa "a", dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV "Zbatimi i MFK", pika, 4.2.8 "Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive të Sektorit Publik", germa "a", njësia ka hartuar Draft Strategjinë e cila përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit por nuk e ka miratuar atë.

Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 20 "Mjedisi i kontrollit", pika 2, germa "a" dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 "Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)", paragrafi "Integriteti dhe vlerat etike", njësia nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III "Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit", pika 3.2 "Cikli i MFK-së", Hapi 5 "Gjurmët e auditimit", njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë

menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj,

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë vitit 2015, janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës. Trajnimet janë kryer në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike por, vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij, *më hollësisht është trajtuar në pikën IV faqet 222-225 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Në funksion të rritjes së cilësisë të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masat e duhura për të miratuar planin strategjik duke e azhurnuar atë çdo viti duke përcaktuar me kujdes objektivat strategjike, prioritetet e institucionit, planet e veprimit, etj., në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar Kodin Etik, rregullore apo udhëzim për zbatimin e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave, si dhe të hartojë një procedurë me qëllim raportimin e shkeljeve të legjislationit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

-Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, institucioni krahas trajnimeve të kryera, të hartojë dhe programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, punonjësit të trajnohen dhe për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut.

-Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

*Menjëherë*

**15. Për vitin 2014 nga auditimi i realizuar mbi planifikimin në nivel programi dhe realizimin e tyre u konstatua sa më poshtë:**

a. Për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 3% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 93%. U konstatuan disakordanca mes informacionit të dhënë nga raporti i monitorimit dhe atij të dhënë në anekse për secilin program të detajuar. Konkretisht për programin ‘planifikim, menaxhim, administrim’ zëri i detyrimeve vjetore financiare për anëtarësim në organizata ndërkombëtare statusin e realizimit në raport e kishte ‘aspak’ ndërkohë që në aneks rezultonte i realizuar ‘plotësisht’, e njëjta gjë vlen edhe për programin ‘përmirësim i kushteve të punës’.

b. Për programin “Siguria ushqimore” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 20% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën 99%. Për të u konstatua se mungonte vendosja e vlerës monetare që ai zinte në totalin e buxhetit, si dhe rrjedhimisht pesha specifike. Për këtë program disakordancat u konstatuan në zërin ‘kafshë/gjedhë remonti’ nga ‘plotësisht’ statusin e realizimit në raport monitorimi në ‘pjesërisht’, si dhe ‘molusqet bivalente’ dhe ‘derrat e vaksinuar kundër mortajës’.

c. Për programin “Infrastrukturë e ujitjes dhe kullimit” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 32% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 98%, u konstatua se mungonte vendosja e vlerës monetare që ai zinte në totalin e buxhetit, si dhe rrjedhimisht pesha specifike.

e. Për programin “Menaxhim i qëndrueshëm i tokës bujqësore” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 0.3% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 92%, mungonte tabela e realizimit.

f. Për programin “Menaxhim i peshkimit” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 6% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 99%, u konstatuan mospërputhje në statusin e realizimit përsa i përket QNOD nga ‘*aspak*’ në raport monitorimi në ‘*plotësisht*’ në aneks dhe së fundmi .

g. Për programin “Administrim i ujërave” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 2% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 86%, u konstatua se mungonte vendosja e vlerës monetare që ai zinte në totalin e buxhetit, dhe pesha specifike, si dhe statusi i realizimit për të gjithë zërat nga plotësisht në pjesërisht

h. Për programin “Këshillim dhe informacion bujqësor” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 3% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 95%, u konstatua se mungonte vendosja e vlerës monetare që ai zinte në totalin e buxhetit, dhe pesha specifike, si dhe statusi i realizimit për të gjithë zërat nga ‘*plotësisht*’ në ‘*pjesërisht*’

**Për vitin 2015 nga auditimi i realizuar mbi planifikimin në nivel programi dhe realizimin e tyre u konstatua sa më poshtë:**

a. Për programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 3% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 93%.

U konstatua se për programin “planifikim, menaxhim, administrim” zëri i detyrimeve vjetore financiare për anëtarësim në organizata ndërkombëtare statusin e realizimit në raportim e kishte ‘*aspak*’ ndërkohë që në aneks rezultonte i realizuar ‘*plotësisht*’, e njëjta gjë vlen edhe për zërin “*realizim i kushteve të punës*”.

b. Për programin “Siguria ushqimore” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 20% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 99%. Për të u konstatua se mungonte vendosja e vlerës monetare që ai zinte në totalin e buxhetit, si dhe rrjedhimisht pesha specifike. Për këtë program disakordancat u konstatuan në zërin kafshë/gjedhë remonti nga plotësisht statusin e realizimit në raport monitorimi në pjesërisht, si dhe molusqet bivalente dhe derrat e vaksinuar kundër mortajës.

c. Për programin “Infrastrukturë e ujitjes dhe kullimit” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 32% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 98%, u konstatua se mungonte vendosja e vlerës monetare që ai zinte në totalin e buxhetit, si dhe rrjedhimisht pesha specifike.

d. Për programin “Zhvillimi rajonal mbështetje e prodhimit bujqësor, blegtoral” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 34% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 99%, nuk u konstatuan problematika

e. Për programin “Menaxhim i qëndrueshëm i tokës bujqësore” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 0.3% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 92%, mungonte tabela e realizimit

f. Për programin “Menaxhim i peshkimit” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 6% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 99%, u konstatuan mospërputhje në statusin e realizimit përsa i përket QNOD nga *aspak* në plotësisht.

g. Për programin “Administrim i ujërave” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 2% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 86%, u konstatua se mungonte vendosja e vlerës monetare që ai zinte në totalin e buxhetit, dhe pesha specifike, si dhe statusi i realizimit për të gjithë zërat nga plotësisht në pjesërisht.

h. Për programin “Këshillim dhe informacion bujqësor” shpenzimet për të përfaqësojnë rreth 3% të totalit të fondeve buxhetore dhe është realizuar në masën prej 95%, u konstatua se mungonte vendosja e vlerës monetare që ai zinte në totalin e buxhetit, dhe pesha specifike, si dhe statusi i realizimit për të gjithë zërat nga plotësisht në pjesërisht

Pra si përfundim mund të themi se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit u konstatuan disakordanca mes të dhënave të paraqitura në raportin e monitorimit dërguar Ministrisë së Financave dhe të dhënave në aneksin mbi raportin e realizimit të produkteve të programit për buxhetin, konkretisht në statusin e realizimit të produkteve si dhe komentet e dhëna mbi to janë tepër evazive. Raporti i monitorimit i pasqyruar nga ana e Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave ishte i ndërtuar konform ligjit, por në analizën e detajuar të realizuar mbi secilin program u vunë re disakordanca midis raportit dhe anekseve, kjo lë vend të mendohet për një hartim formal të tyre dhe informacioni i dhënë të mos jetë i besueshëm për përdoruesit. Institucioni në fazën e hartimit të PBA duhet të tregohet më i kujdesshëm dhe të marr në konsideratë të gjitha nevojat reale të njësisë duke qëndruar sa më realist në atë fazë. *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit,*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Nga analiza e kryer mbi programet e institucionit, rekomandohet se duhet të tregohet më tepër kujdes në formulimin e objektivave të tyre. Po ashtu vëmendje e madhe duhet treguar edhe në çastin e përcaktimit të kostos për secilin produkt të programit.

- Në planifikimin dhe monitorimin e realizimit të programeve ekipet menaxhuese dhe strukturat drejtuese të ministrisë, të studiojnë e të konkludojnë seriozisht sa më sipër që të shmangen disakordancat mes informacioneve të nxjerra nga i njëjti burim.

- Rekomandimi që do të linim mbi punën e EMP, nisur nga natyra delikate e punës së tyre duhet shmangur problematika e mungesës së procesverbalet për të dokumentuar mbledhjet e realizuara prej tyre. Bazuar edhe në mënyrën jo fortë korrekte të hartimit të objektivave, planifikimit dhe buxhetimit, si dhe përlllogaritjes së kostos së produkteve theksojmë se është problematik e institucionit mos funksionimi serioz i këtyre ekipeve dhe duhet te merren masa për të shmangur këtë praktikë.

*Në vazhdimësi*

**16. Për vitin 2014 nga auditimi në lidhje me analizën e realizuar mbi përcaktimin e kostos për njësi për çdo produkt programi nga ana e institucionit, konstatohet sa më poshtë:**

- Për programin siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit, produkti “kafshë të identifikuar në të gjithë vendin, gjedhë të imëta” konstatohet një rritje e totalit të shpenzimeve për 2014, me rreth 137% dhe më pas mbetet konstante gjatë dy viteve. Konstatohet një luhatje e madhe e kostos për njësi ndërkohë që sasia e produktit është e pandryshueshme dhe nuk është dhënë asnjë informacion në lidhje me çmimet, trendin e tyre që mund të ndikoj në këtë fenomen.

- Për programin siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit, produkti “kafshë shtëpiake të vaksinuara kundër tërbimit” dhe “rrënjë ullinj dhe pemë frutore të trajtuara kundër mizës dhe furrtares të bardhë të mani” konstatohet në raport monitorimi se kosto për njësi mbetet konstante gjatë 4 viteve, ndërkohë që trendi i çmimeve të vaksinave dhe pesticideve në kohë, ka ndryshuar.

- Programi siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit, produkti “Projekte në fushën e mbrojtjes së shëndetit të njerëzve” në planifikimin që bëhet konstatohet se numri i projekteve të planifikuara rritet dhe pastaj qëndron konstant ndërkohë që kosto për njësi është e luhatshme, ndërsa ajo totale kur numri i projekteve është konstant trefishohet.

- Programi zhvillimi rural, produkti “Ruajtja e resurseve gjenetike në fermë” mungon formulimi i objektivave të programit për pasojë nuk mund të dal në pah ideja se cili është produkti, njëkohësisht njësia matëse e vendosur në numër nuk arrin të kuptohet se çfarë mat realisht.

- Programi zhvillimi rural, produkti “Rritje me 25% e certifikimit të farave të grurit, misrit, patates dhe perimeve si dhe rritje me 10% e analizave dhe testimeve” së pari e formuluar në këtë trajtë më tepër se produkt të jep përshtypjen e objektivit, së dyti konstatohet se ndërkohë që sasia planifikohet të ulet totali i shpenzimeve rritet, por nuk argumentohet se pse ka ardhur kjo gjë, kaq shumë parashikohet të rritet çmimi i lëndës së parë?

- Programi zhvillimi rural, produkti “*Mbështetje strukturore për zbatimin e të gjitha skemave*” në planifikimin që bëhet konstatohet se sasia mbetet konstante ndërkohë që kosto vjen duke u rritur, vitin e parë me 4% dhe më pas me 99.6%, si justifikohet kjo? Apo krahasuar me aktualin 2014 rritet me 50% dhe me 2016 me gati 100% ndërkohë që sasia mbetet.

**Për vitin 2015 nga auditimi në lidhje me analizën e realizuar mbi përcaktimin e kostos për njësi për çdo produkt programi nga ana e institucionit, konstatohet sa më poshtë:**

Nga auditimi i kryer mbi hartimin e projekt buxhetit afatmesëm për vitin 2015, prej grupit të auditimit u konstatua se përqindja e realizimit ndaj planit fillestar është më e ulët krahasuar me përqindjen e realizimit ndaj planit përfundimtar, gjë e cila na lë të mendojmë se mund të ketë pasur probleme në fazë e hartimit të projektbuxhetit.

- Nga analiza e kryer mbi programet konstatohet se për programin planifikim, menaxhim dhe administrim; produkti “materiale dhe shërbime të përgjithshme zyre, shpenzime transporti, udhëtime brenda dhe jashtë vendit dhe të tjera operative” nga formulimi i objektivave të programit nuk arrin të dal qartazi ideja se cili është produkti dhe njësia matëse e vendosur në numër nuk arrin të kuptohet se çfarë mat realisht.

- Për programin siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit, produkti “*kafshë të identifikuar në të gjithë vendin, gjedhë të imëta*” konstatohet një rritje e totalit të shpenzimeve për 2015, me rreth 148%, ndërkohë që numri i krerëve të matrikulluar nuk dyfishohet për të justifikuar koston.

- Për programin zhvillimi rural, produkti “*hartimi i vrojtimeve statistikore, pyetësorëve*” konstatohet se shpenzimet totale të produktit mbeten të pandryshuara gjatë 4 viteve, sasia e e produktit mbetet e pandryshuar për tre vite dhe vitin e katërt rritet me 2900%, një rritje e tillë e sasisë është e pa argumentuar, dhe është shoqëruar edhe me një ulje të koston për njësi.

- Për programin menaxhimi i peshkimit, produkti “*kontrata për leje peshkimi*” konstatohet se sasia e produktit rritet ndërkohë që kosto për njësi ulet. Arsyen për një luhatshmëri të tillë për sa kohë që procedurat për miratim dhe leje peshkimi nuk ndryshojnë institucioni nuk e jep, *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Duhet të merren masa nga ana e institucionit që hartimi i parashikimeve të bëhet mbi terma real dhe të argumentuar, duke shmangur në këto kushte parashikime të pabazuara dhe jo realiste.

*Në vazhdimësi*

**17.** Nga auditimi i programimit, aprovimit, detajimit dhe monitorimit të buxhetit për të tre vitet periudhe auditimi, 2014, 2015 dhe 2016 u konstatua se:

- Institucioni, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Nëpunësit autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, jo më pak se katër herë në vit, te nëpunësi i parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo projekt të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”, konstatohet se ka diferenca sa i takon analizës së produkteve. Gjithashtu konstatohet se, ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së koston së produkteve, në një mjet jo të qëndrueshëm dhe efektiv.

- Konstatohen problematika në lidhje me metodologjitë e planifikimit sipas qendrave të koston të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj. (Sikundër është argumentuar në gjetjen 1 dhe 2 ), *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e investimeve në Ministrinë e Financave, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së informacionit me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim që ndryshimet në shpenzime gjatë vitit të jenë sa më të vogla dhe të kufizohen vetëm në ndryshimet të domosdoshme dhe të pashmangshme

- Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme për të shpërndarë shpenzimet (kostot) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim minimizimin deri në eliminimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Institucioni mund të përdorë një sërë metodash, apo praktikat më të mira që sot aplikohen.

*Në vazhdimësi*

**18.** Konstatohet se ndjekja e realizimit të buxhetit dhe raportimi i tij kryhet nëpërmjet raporteve të monitorimit të buxhetit, veçanërisht ndjeshëm në 2014, por edhe 2015 u konstatua nga analiza krahasimore mes të dhënave të gjeneruara prej raporteve monitoruese të Ministrisë së Financave edhe atyre të nxjerra nga subjekti, prania e disakordancave në shifra. Po ashtu realizimi faktik i shpenzimeve në total për programe është i ndryshëm në tabela të ndryshme të raportimit nga ministria, pavarësisht se çdo shpenzim buxhetor është kryer mbi bazën e urdhër-shpenzimeve të plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara dhe firmosur rregullisht.

Për vitin 2014 diferencat në total janë 153 milion lekë më pak raportuar nga MBZHRAU krahasuar me sistemin e thesarit të Ministrisë së Financave. Konkretisht 17 milion lekë janë shpenzime korrente më pak në programin 04220 Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit dhe 136 milion lekë janë shpenzime kapitale më pak si rrjedhojë e përfshirjes në raportin e monitorimit nga ana e ministrisë të të gjitha investimeve me financimin e huaj, pra edhe të atyre që **nuk** evidentohen në sistemin e thesarit dhe i dyti faktor që ndikon në këtë diferencë është fakti se i është referuar raporteve të projekteve duke raportuar në nivel shpenzimi nga ana e MBZHRAU-së, ndërsa nga Ministria e Financave i është referuar raporteve të projekteve, jashtë sistemit, por në nivel disbursimi i cili është më i lartë se niveli i shpenzuar.

Për vitin 2015 diferencat në total tek plani përfundimtar janë 110 milion lekë më shumë raportuar nga MBZHRAU krahasuar me sistemin e thesarit të Ministrisë së Financave. Kjo diferencë përfaqëson Programin 05640 “Administrimi i Ujërave” program i transferuar nga Ministria e Mjedisit me Aktin Normativ Nr.1 të rishikimit të buxhetit të vitit 2015. Ministria e Financave ka referuar për plan vetëm shtesën kryer në kuadër të këtij rishikimi (buxhet i mbetur pa shpenzuar për muajt gusht-dhjetor), duke lënë jashtë pjesën tjetër janar –korrik e cila me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 18171/1, datë 16.02.2015, është përcaktuar që përdorimi dhe administrimi i fondeve për programin 05640 “Administrimi i Ujërave”, të bëhet nga MBZHRAU, pra grupi 05 megjithëse është e akorduar në grupin 26.

Diferencat në fakt për 208 milion më shumë se Ministria e Financave, janë si rrjedhojë 109 milion lekë fakti i muajve janar korrik i programit 05640 “Administrimi i Ujërave” dhe 99 milion lekë është rrjedhojë e përfshirjes në raportin e monitorimit nga ana e Ministrisë së Financave të të gjitha investimeve me financimin e huaj, pra edhe të atyre që nuk evidentohen në sistemin e thesarit, *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

- Sikundër konstatohet ekziston një disakordim vlerash të raportuara i cili ka ardhur si rrjedhojë e ndryshimit mes bazës së përdorur për raportim prej dy institucioneve dhe së dyti prej faktit se Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nuk pasqyron në raportim

tek Ministria e Financave ato shpenzime të cilat nuk evidentohen në sistemin e thesarit. Kjo bën që të kemi dy pamje të ndryshme që nuk rakordojnë me njëra tjetrën, duke krijuar konfuzion përse i përket leximit të buxhetit.

- Nga ana e institucioneve duhet të merren masa të menjëhershme për të unifikuar mënyrën e raportimit që të shmanget praktika e mësipërme. Në mënyrë të veçantë Ministria e Financave të marr masa që të jetë në sinkron me raportimin e MBZHRAU-së.

- Po ashtu duke mbajtur në konsideratë natyrën e veçantë të produkteve që institucioni ofron sugjerohet që monitorimi i buxhetit i cili kryhet si në nivel artikulli dhe kapitulli ashtu edhe në bazë të produkteve, raportet e monitorimit duhet të jenë më të plotë dhe të kenë të dhëna të detajuara si në vlerë edhe në përqindje. Procesi kualitativ i monitorimit dhe vlerësimit të ofrojë pasqyrë të qartë rreth arritjes së rezultateve dhe objektivave të synuara. Informacionet që institucioni zotëron mbi ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, së bashku me shpjegimet përkatëse, shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë, argumentet që lidhen me mosrealizimin e produkteve duke paraqitur masat që parashikohen në të ardhmen për realizimin e tyre, si edhe analiza e kostos së produkteve duke paraqitur shpjegimet përkatëse në rastin e kostove shtesë të realizuara sipas ligjit duhet të jenë sa më të plota dhe reale për tju bashkangjitur raportit të monitorimit të buxhetit. Raportet e monitorimit të kësaj ministrie duhet të shpjegojnë më mirë ecurinë e realizimit të produkteve në të gjitha programet. Duhet të jenë më të plotë dhe po ashtu të kenë të dhëna të detajuara si në vlerë edhe në përqindje.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**19.** Për vitin 2014 në akt rakordimin në nivel artikulli mes përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave u konstatua se ai përmban mungesa konkretisht u konstatua se në planin përfundimtar llogaria 600 dhe 601 nuk ishin hedhur fare ndërkohë që në planin fillestar mungonte llogaria 606. Problematik kjo e cila nuk është përsëritur në vitet e mëpasshme.

- Konstatohet prej auditimit se për sa i përket shifrave të ekspozuara në gjendjen në fillim të AQT-ve në pasqyrën nr.6 “Gjendja dhe ndryshimet e AQT-ve në vlerë bruto” të cilat duhet të jenë të barabarta me ato të aktivitetit të bilancit, grupi i AQT-ve, ushtrimi paraardhës, ky postulat përmbushet por ka njëfarë problematike në llogarinë 203 “koncesione, patenta, licenca e tjera të ngjashme”. Ku referuar formatit 6 për të dy vitet, në çelje nuk merren në konsideratë shtesat/pakësimet e realizuara gjatë vitit, për të nxjerrë gjendjen në fund të periudhës. Për vitin 2014 çelja është 6,974 mijë lekë dhe me shtesa prej 2,269 mijë lekë shkon 9,243 mijë lekë, e cila duhet të ishte çelja e formatit 6 të 2015. Për vitin 2015 çelja është 6,974 mijë lekë aq sa ajo e 2014 dhe nuk korrespondon as me mbylljen 2014! Me shtesa 899 mijë lekë shkon në vlerën 7,873 mijë lekë ndërkohë që duhet të ishte 9,243 mijë plus 899 mijë lekë të shkonte 10,142 mijë lekë. Ndërkohë që në formatin numër 1 “Arkivi i Bilancit Kontabël” si rrjedhojë e plotësimit të formatit standart të kërkuar prej Ministrisë së Financave këto vlerë janë të ndara mes llogarive 203 “koncesione, patenta, licenca e tjera të ngjashme” ku pasqyrohen vlerat e aktivitetit pa I marr në konsideratë shtesa/pikësimet dhe llogarisë 230 “shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara” ku pasqyrohen vetëm ndryshimet e ndodhura gjatë vitit.

Pra përmbledhtazi mund të themi se llog 203 ”Koncesione, patenta, licenca të ngjashme” në formatin 6, nuk merr në konsideratë ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, dhe e tillë kjo vlerë është mbartur edhe nëpër vitet e mëpasshme, *më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 60-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga ana e MBZHRAU si institucion qendror së bashku me institucionet e vartësisë, të analizohet plotësisht situata mbi debitorët duke i ndarë në grupe, për ata me shpresë arkëtimi, të vazhdohen procedurat ligjore për arkëtimin e tyre dhe të vlerësohet realisht situata për ata debitorë të cilët

mendohet të jenë pa shpresë arkëtimi, duke u përpjekur të vilet edhe një pjesë sado e vogël e detyrimeve, gjithashtu të rishikohen dhe krijohen skema të favorshme që fermerët të jenë të gatshëm për arkëtimin e shumave për të cilat janë debitorë.

Gjithashtu MBZHRAU si Institucion Qendror në bashkëpunim me institucionet debitore të varësisë dhe Ministrinë e Financave, të marr masa me qëllim që të përshtaten skema alternative shlyerje që fermerët të jenë të gatshëm për derdhjen e shumave për të cilat janë debitorë. (Nisur nga fakti që skema shoqërohet me nivel relativisht të lartë debitorësh duhet të shtohet vëmendja tek mënyra e funksionimit të skemës dhe veçanërisht në sanksionimin e të drejtave dhe detyrimeve e palëve).

Të ketë sanksione të ekzekutueshme menjëherë për rastin e deviacioneve nga objektivat e skemës dhe në të gjitha rastet të vlerësohen drejt instrumentet që do të mundësonin mbrojtjen e interesave të shtetit. Për të gjitha rastet e shtesës së debitorëve të analizohen edhe përgjegjësitë institucionale që kanë krijuar kushtet për rritjen e debitorëve.

Gjithashtu gjykohet e arsyeshme që institucionet e varësisë, të krijojnë një regjistër ku të bëjnë një ndarje të detyrimeve sa janë me shpresë arkëtimi apo likuidimi, sa janë të mbartur për mbi 5 vjet, sa nuk janë likuiduar apo arkëtuar për faj të strukturave që duhet të merren me to dhe sa prej tyre nuk kanë më shpresë arkëtimi. MBZHRAU, Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me njësitë e varësisë të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme arkëtimin e detyrimeve, si dhe të bëjë sistemimin e tyre mbështetur në legjislacionin në fuqi.

-Të merren masa për të unifikuar paraqitjen mes pasqyrave ndihmëse dhe kontabël që të shmangin keqkuptimet në informacionin e ofruar përmes shifrave. Pavarësisht se pasqyrohet shtesa në formatin e Bilancit Kontabël duhet të pasqyrohet e njëjta situatë edhe përsa I përket ndryshimit dhe gjendjes së aktiveve, duke sugjeruar si mundësi zgjidhje shtimin e një rreshti me llogarinë “shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara” apo dhënien e një informacioni ekstra se në llogarinë 203 përfshihet edhe ajo 230.

*Në vazhdimësi*

**20.** Nga auditimi konstatohet se Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nuk ka të krijuar një **regjistër të aseteve në tërësi**, si dhe regjistër **të pronave të paluajtshme në veçanti** për të gjithë sistemin (edhe për vartësitë të jetë i depozituar një regjistër pranë institucionit qendror) dhe as regjistër të pronave të dhëna me qira, në papajtueshmëri me kërkesat e udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e njësive në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu III. “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 60-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

*Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*, të marrë masat e nevojshme në bashkëpunim me institucionet e vartësisë, për hartimin e regjistrit të aktiveve me gjithë të dhënat, në zbatim të kërkesave të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e njësive në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu III.

Institucionet e vartësisë të depozitojnë pranë MBZHRAU një kopje të regjistrit të vet në mënyrë të tillë që ti vihet në ndihmë njësisë qendrore në hartimin e pasqyrave të konsoliduar.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**21.** Nga auditimi konstatohet se Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave trashëgon **personel debitor me detyrimet ndaj institucionit** të cilët në total deri më 31.12.2016, janë në vlerën **381,561 lekë**, një nivel jo i lartë ky i debitorëve por i shoqëruar me shpenzime gjyqësore dhe pa një zgjidhje të situatës. Konstatohet se detyrimet e *personelit ndaj institucionit, nga viti 2013 në 2014 janë shtuar me vlerën 14,594 lekë dhe nga viti 2014 në 2015 nuk kanë patur asnjë ndryshim, pra është mbartur e njëjta vlerë prej 381,561 lekë dhe nuk ka asnjë shenjë reale për arkëtimin e tyre.*



Nga auditimi gjithashtu u konstatua se MBZHRAU-ja trashëgon në **mënyrë të qëndrueshme debitorë** dhe kreditorë, të cilët në total deri më 31.12.2015, janë në vlerën **2,032,344 lekë**, një nivel i lartë ky, i debitorëve të mbartur nga viti 2006 sipas detyrës lënë nga auditimi i Ministrisë së Bujqësisë, për orë jashtë orarit të punës të paguara, konstatim shkelje nga KLSH dhe që nuk janë më në marrëdhënie pune me Ministrinë. Ndërsa vlera e kreditorëve është 437.340 lekë dhe përfaqëson kondrapartin e llogarisë gjendje në bankën Raiffeissen dhe është shuma e kontributeve të derdhura nga fermerët para vitit 2005 për matrikullimin e kafshëve të gjalla si pjesë e ish projektit të matrikullimit, realizuar nga PHARE mbartur nga ISUV, më *hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 60-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave pas analizimit të situatës mbi debitorët, të vlerësojë të gjitha mundësitë për arkëtimin qoftë edhe pjesor të detyrimeve dhe të përshtatë skema alternative shlyerje. Të ketë sanksione të ekzekutueshme menjëherë dhe në të gjitha rastet të vlerësohen drejt instrumentet që do të mundësonin mbrojtjen e interesave të shtetit. Për të gjitha rastet e shtesës së debitorëve të analizohen edhe përgjegjësitë institucionale që kanë krijuar kushtet për rritjen e tyre.

*Menjëherë dhe në vazhdim*

**22.** Nga auditimi i kryer mbi periudhën objekt auditimi rezultoi se në relacionin shoqërues të Pasqyrave Financiare shpjegimi analitik për llogarinë e **Granteve Korrente** është më shumë se i vakët, ai mungon plotësisht, dhe në këto kushte lexuesi i pasqyrave nuk arrin të marrë asnjë feedback mbi origjinën, kohën se kur janë marrë apo nëse janë marrë kundrejt kushtit apo jo. Po ashtu u konstatua se edhe në shënimet shpjeguese mungon informacioni rreth këtyre investimeve dhe burimit të financimit për to, ndërkohë që vet kuadri ligjor, ta kërkon specifikisht një informacion të tillë *Udhëzimi nr. 17, datë 25.09.2012 “Për qarkullimin pa pagesë të aktiveve brenda një sive shpenzuese”*. Theksohet se në çdo rast dhe në vijim, informacione të tilla duhet të reflektohen edhe në relacionin shpjegues që shoqëron pasqyrat financiare, më *hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 60-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Informacioni në pasqyrat financiare duhet të paraqitet në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe pa ekuivok, në mënyrë të tillë që përdoruesit e pasqyrave financiare të mund të kuptojnë ato. Institucioni të marrë masa që të pasqyrojë informacionin si në relacionin shoqërues ashtu edhe në shënimet shpjeguese rreth granteve dhe zërave të tjerë sensitive për buxhetin, në mënyrë që lexuesi i pasqyrave financiare të kuptojë gjendjen e institucionit.

*Menjëherë*

**23.** Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, për intervalin e viteve të marra në analizë, u konstatua se për vitin 2014 mungonte regjistri i aktiveve ndërsa për vitin 2015 dhe 2016 nga auditimi i procedurës se mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore dhe njësi dispononte një **regjistër kontabël të aktiveve**. Por ky regjistër më tepër vjen në formën e **një kartele** se të regjistrit, sikundër e kërkon Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 28, “*Regjistri i aktiveve të njësisë, duhet të përfshijë si aktivet afatgjatë ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital”*.

Si përfundim themi se MBZHBRAU nuk ka një **regjistër analitik aktivesh sipas formatit zyrtar** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të

mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike, sipas pikës 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, por posedon një regjistër në formë të sintetizuar ndërsa regjistri i përshtatur sipas kërkesave të ligjit ishte në formë drafti, por deri në përfundim të periudhës së auditimit nuk arriti të zyrtarizohej, më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 60-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nëpunësi Autorizues i njësisë brenda strukturës së institucionit, të caktojë nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të aktiveve. Regjistri i aktiveve të njësisë, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë. MBZHRAU duhet të përfundojë zyrtarizimin e këtij **regjistri** i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

*Menjëherë*

**24.** Në lidhje me gjendjen e inventarëve në fund të vitit u konstatua se në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të Urdhrit nr.594 datë 16.12.2015, “Për kryerjen e inventarit të përgjithshëm” për vitet 2015 dhe 2016 institucioni ka kryer procesin e inventarizimit në fund të vitit dhe rezultoi se nga auditimi i kryer mbi “**llogarinë 311**” inventarin e materialeve të konsumit, konstatohet se janë gjendje pjesë këmbimi për makina të ndryshme të cilat kanë qënë në përdorim të Ministrisë së Bujqësisë që para viteve 2000. Aktualisht kjo pjesë inventari *ndodhet stok në magazinë*, pasi Ministria nuk disponon mjete të atilla që mund t’i përdorë këto pjesë këmbimi dhe gjithashtu ato pjesë i përkasin një kategorie makinash që *nuk janë në përdorim*. Në magazinë ka një gjendje të konsiderueshme të kompjuterëve ardhur nga projekte PMU, ASP e FAO, por të cilët nuk janë më në gjendje pune. Vlerat e tyre në kontabilitet janë të larta dhe për rrjedhojë edhe amortizimi historik i tyre, nuk justifikon nxjerrjet jashtë përdorimit, më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 60-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Për sa më sipër bazuar në vlerësimin e realizuar në fund të periudhës rekomandojmë se:

- Në lidhje me pjesën e inventarit që ndodhet stok në magazinë, të cilat i përkasin një kategorie makinash që nuk janë në përdorim dhe Ministria nuk disponon mjete për të mund t’i përdorur këto pjesë këmbimi rekomandohet vlerësimi i tyre dhe më pas gjykimi për të **realizuar kalimin në rezervat e shtetit apo nxjerrje jashtë përdorimit**.

- Në lidhje me kompjuterat të cilët janë gjendje në magazinë por nuk janë në gjendje pune rekomandojmë ngritjen e një grupi për vlerësimin real të tyre dhe marrjen e masave për **nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre** apo transferimin kapital të tyre sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave

*Menjëherë dhe në vazhdim*

## **C. MASA SHPËRBLIM DËMI.**

**1.** Nga auditimi i dokumenteve për lidhjen e zbatimit e kontratave të shërbimit e mirëmbajtjes të sistemit BLU-BOX, ka rezultuar se periudha kohore nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e objektit të prokurimit, nuk përkon me periudhën e parashikuar në dokumentet e

tenderit, lidhur me afatet e ekzekutimit të kontratës (për shkaqe të autoritetit kontraktor ose jashtë kontrollit të tij). Kohëzgjatja e shërbimit në kontratat e nënshkruara, ka qenë gjithnjë më e shkurtër se ajo e parashikuar në dokumentet e tenderit. Por, megjithëse është zvogëluar kohëzgjatja e shërbimit, fondi limit për rrjedhojë dhe ai i kontraktuar, nuk kanë ndryshuar. Logjikisht zvogëlimi i afatit të kryerjes së shërbimit të mirëmbajtjes (sipas kontratës), do të thotë më pak shpenzime dhe vlera e kontratës duhet të ishte më e vogël, pasi shërbimi është ofruar në një kohë më të shkurtër. Nga kjo parregullsi dhe shkelje në lidhjen e zbatimit të kontratës në raport me kërkesat e përcaktuara në DT, është përfituar padrejtësisht shuma **3,278,345 lekë me TVSH**.

***Për këtë rekomandojmë:***

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” të ndryshuar, pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV, pika 93, Titullari i MBZHRAU të nxjerrë aktet administrative sipas nenit 640 të Kodit Civil, për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit, në vlerën totale **3,278,345 lekë me TVSH**. Të ndiqen hapat administrative e ligjore, për të reregjistruar në kontabilitet detyrimin dhe në vijimësi të kërkohet arkëtimi i vlerës 636,637 lekë me TVSH, nga operatori ekonomik “I” shpk dhe 2,641,708 lekë me TVSH nga OE “RC” shpk.

*Menjëherë*

2. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” të ndryshuar, pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV, pika 93, nga titullari i MBZHRAU të nxirren aktet administrative sipas nenit 640 të Kodit Civil, për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit, në vlerën totale **13,455,090 lekë me TVSH**, si qira e pa paguar nga operatorët privatë, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga titullari i MBZHRAU të nxirren aktet administrative, për të kërkuar arkëtimin, në vlerën totale **13,455,090 lekë me TVSH**, si qira e pa paguar nga operatorët privatë (*anex.1 bashkëngjitur*), duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi.

*Menjëherë*

3. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” të ndryshuar, pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV, pika 93, nga titullari i MBZHRAU të nxirren aktet administrative sipas nenit 640 të Kodit Civil, si dhe në bazë të Kontratës koncesionare me Agrotal-1 ,për të aplikuar penalitetet, në vlerën totale **54, 000 Euro** si penalitet i pa aplikuar për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale nga Koncesionari, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga titullari i MBZHRAU të nxirren aktet administrative, për të kërkuar arkëtimin, në vlerën totale **54, 000 Euro** si penalitet i pa aplikuar për mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale nga Koncesionari A, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi.

*Menjëherë*

4. Në procesverbalin e ndryshimeve të objektit “**Rehabilitimi i Kanalit VLF, pjesa e dyte (progresivi 12595-22622)**” është konstatuar nga firma ndërtuese dhe mbikëqyrësi, se në gjatësinë 789 ml në pjesën e bazës së kanalit, gjendet formacion shkëmbor. Sipas arsyetimit të firmës zbatuese dhe mbikëqyrësit ky formacion duhej hequr, në mënyrë që baza e kanalit të shkoj sipas projektit. Si rrjedhojë në preventivin e ripunuar është shtuar zëri i punimeve: “Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në sasinë 2770 m<sup>3</sup> dhe me vlerë të situacionuar 4,902,900 lekë.

Për të argumentuar konstatimin e këtij zëri punimesh dhe ndërhyrjen që duhej kryer për të realizuar gërmimin e shkëmbit, në dosje nuk është paraqitur asnjë raport gjeologjik, në të cilin konstatohet prania e shtresave shkëmbore përgjatë kanalit. Gjithashtu në fotot të cilat ndodhen në dosjen e zbatimit, nuk evidentohet prania e formacioneve shkëmbore dhe punimet për ti gërmuar ato. Zëri i punimeve “Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” nuk është kryer duke shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën **4,902,900 lekë pa t.v.sh.**

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga titullari i MBZHRAU ose titullari i Bordit të Kullimit Fier, të nxirren aktet administrative, për të kërkuar arkëtimin e vlerës 4,902,900 lekë pa t.v.sh, e përfituar më tepër nga **BOE “Sh” sh.p.k & “F”sh.p.k & “GK” sh.p.k.**

*Menjëherë*

5. Në objektin “**Kanali Kryesor Ujitës Mat-Lezhë**” u konstatua se një pjesë e sasisë prej sasia e shtuar në preventivin e rishikuar dhe në situacion prej 24,566 m<sup>3</sup> nuk është gërmuar me krahë por me ekskavator. Në projektin fillestar ishte parashikuar që të ndërtoheshin 2 ura automobilistike “Ura Auto HD= 2 m, B= 4 m” në piketat 62 dhe 86”, ura të cilat nuk janë ndërtuar, po në vend të tyre janë vendosur tombino, duke devijuar nga projekti fillestar. Vlera e këtyre dy zërave në situacion është **5,852,844 lekë pa t.v.sh.**

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga titullari i MBZHRAU ose titullari i Bordit të Kullimit Lezhë, të nxirren aktet administrative, për të kërkuar arkëtimin e vlerës **5,852,844 lekë pa t.v.sh,** e përfituar më tepër nga **OE “K” sh.a.**

*Menjëherë*

6. Në objektin “**Kanali Kryesor Ujitës i Rezervuarit Gjanç zona Pulahe, Korçë**” nga auditimi i dokumentacionit të zbatimit rezultuan diferenca në punime të pa kryera në vlerën **322,800 lekë pa t.v.sh,** në zërin “Mbushje me gurë ose zaje lumi”.

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga titullari i MBZHRAU ose titullari i Bordit të Kullimit Korçë, të nxirren aktet administrative, për të kërkuar arkëtimin e vlerës **1,175,960 lekë pa t.v.sh,** e përfituar më tepër nga **OE “B” sh.p.k.**

*Menjëherë*

## **D. MASA DISIPLINORE.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në referim të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 “Statusi i nëpunësit civil”, datë 13.05.2013 dhe kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si mbështetur në nenet e ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në germën (c dhe ç) të nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i **rekomandoj Ministrit të MBZHRAU-s, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, për të gjithë**

**personat të cilët në Raportin Përfundimtar të Auditimi janë ngarkuar me përgjegjësi konkrete, ndërkohë që cilësojmë**

**D/1.** Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, në referim të nenit 57, 58, 59 të ligjit nr. 152/2013, datë 13.05.2013 “Statusi i nëpunësit civil”, kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” rekomandojmë dhënien e masës disiplinore “Largim nga puna” për:

**Znj. L.G, Drejtore e Integritit European dhe Projekteve në MBZHRAU**, në rolin e Kryetarit të Bordit të dhënies me qira të Tokave, për veprimet e pambështetura ligjore, në procedurat e dhënies me qira të tokave në administrim të kësaj Ministrie, mungesën e një kordinimi të kërkesave individuale për projektet në zhvillim me strategjitë institucionale të zhvillimeve rajonale dhe sektoriale, duke sjellë favorizim të projekteve të cilat nuk kanë rezultuar me ndikim në interesat e shtetit. Mungesën e veprimit duke mos krijuar kushtet për monitorim të kontratave të lidhura, veprim që është në kundërshtim me kapitullin IV pika 22 e VKM nr.460, datë 22.05.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” ku “drejtoria përgjegjëse për administrimin e pronave publike në Ministri, monitoron zbatimin e kontratave të qerasë nga qiramarrësit si dhe ... merr raportime periodike apo kontrollon drejtorinë rjonale të bujqësisë për monitorimet e kryera nga kjo drejtori për zbatimin e kontratës së qerasë.”

**D/2.** Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, në nenin 72/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në referim të nenit 57, 58, 59 të ligjit nr. 152/2013, datë 13.05.2013 “Statusi i nëpunësit civil”, kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Ministrisë të **Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (M.B.ZH.R.A.U)**, referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruar në procesverbalet dhe aktverifikimet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit të vlërësorj shkeljet e konstatuara, dhe të vendosë marrjen e masave administrative dhe disiplinore, në raport me shkeljet e konstatuara, për:

- Për Njësinë e Prokurimit: **Znj. M.K Juriste, Z. G.S Jurist dhe Z. G. Xh, agronom (në 2015 Z. K.N, agronom),**
- Për Grupin e punës, lidhur me përgatitjen e termave të references dhe përlllogaritja e fondit limit **Znj. A.D Ing. IT, Z.T.O ekonomist dhe Z. B.Ç juriste.**
- Për Grupin e punës për llogaritjen e fondit limit, përgatitjen e specifikimeve teknike, i përbërë nga: **Z. A.G inxhinier, Z. S.P mjek veteriner dhe Z. L.K inxhinier ndërtimi.**
- Grupi i punës për llogaritjen e fondit limit, përgatitjen e specifikimeve teknike, i përbërë nga **Z. L. H zooteknik, Znj. M.P zooteknike dhe Znj. E.P zooteknike.**
- Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave **Z. E.F. kryetar, Z. A.L anëtar dhe Znj. E.R anëtare.**
- Për Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave: **z. A.V, znj. A.E. dhe znj. E.M.**
- Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave: **z. L. B Kryetar, dhe znj. E.Z.**
- Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave: **z. K.J Kryetar, z. L.B, anëtar**
- Për Njësinë e Prokurimit: **E.B** për procedurën me objekt “Rehabilitimi i rrjetit te kanalit ujitës te rezervuarit Shishtavec”.
- Për titullarin e Bordit të Kullimit Fier **z. A.C.**

- Për Grupin e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit: **S.N ekonomiste, J.B ekonomiste dhe B. G (Eksperte e jashtme).**

## **E. MASA ADMINISTRATIVE.**

### **1. Inspektoratit të Mbrojtjes së territorit Bashkia Fier.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit, të nenit 7 të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; të Udhëzimit e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, e ndryshuar me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 16.06.2011, të Udhëzimit e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, KLSH ka evidentuar përgjegjësitë individuale dhe i ka pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, faqe 187-200.

Mbështetur në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar, nenin 5/b; Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, nenin 15 “Sanksionet”, Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe bazuar në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandoj Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Fier**, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për:

Mbikëqyrësin e punimeve **z. L.T**, me licencën me nr. MK1666, pasi:

-Në objektin “Rehabilitimi i Kanalit VLF, pjesa e dyte (progresivi 12595-22622)”, është përfituar nga bashkimi i operatorëve ekonomik “*Sh*” sh.p.k & “*F*” sh.p.k & “*GK*” sh.p.k, vlera e punimeve të pakryera **4,902,900 lekë pa t.v.sh** dhe është ndryshuar projekti bazë në mënyre thelbësore, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në kontratën e lidhur me BOE fitues Nr.259/2, datë 13.04.2016 me vlerë të kontratës 60,629,442 lekë me t.v.sh dhe të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, e ndryshuar me UKM Nr.1, datë 16.06.2011.

- Në objektin “Rehabilitimi i Kanalit VLF, pjesa e parë (progresivi 0-12595)”, realizuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik “*N*” sh.p.k & “*H*” sh.p.k & “*N*” sh.p.k, është ndryshuar projekti bazë në mënyre thelbësore dhe janë kryer punime jo efektive dhe të pa kërkuara në projekt-preventiv në një vlerë prej 7,702,731 lekë pa t.v.sh, të cilat nuk kanë ndryshuar kapacitetin e kanalit dhe përmirësuar gjendjen e tij në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në kontratën e lidhur me BOE fitues, Nr.246/2, datë 18.04.2016 me vlerë të kontratës 66,806,145 lekë me t.v.sh dhe të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, e ndryshuar me UKM Nr.1, datë 16.06.2011.

Kolaudatorët e punimeve, përkatësisht **z. L.K** me numër licence MK 0656/1 dhe **znj. B.C** me numër licence MK 0637/2, pasi objekti “Rehabilitimi i Kanalit VLF, pjesa e dyte (progresivi 12595-22622)” nuk është realizuar sipas specifikimeve të projektit, kushteve të kontratës dhe në kundërshtim të Nenit 12 të Ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. *Më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

### **2. Inspektoratit të Mbrojtjes së territorit Bashkia Lezhë**

Mbështetur në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar, nenin 5/b; Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të

ndërtimit”, nenin 15 ”Sanksionet”, Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe bazuar në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ***i rekomandoj Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Lezhë*** që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për:

Mbikëqyrësin e punimeve, firmës “A” sh.p.k me përfaqësues **z. K.S**, me numër licence MK 1672/6, pasi:

Në objektin “Kanali Kryesor Ujitës Mat-Lezhë”, është përfituar operatori ekonomik “K” sh.a, vlera e punimeve të pakryera **5,852,844 lekë pa t.v.sh**, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në kontratën e lidhur me OE fitues Nr.106/3, datë 15.04.2015 me vlerë të kontratës 26,181,093 lekë me t.v.sh.

Kolaudatorët e punimeve, përkatësisht **z. L.B** me numër licence MK 1030 dhe **z. F. D** me numër licence MK 1599, pasi objekti “Kanali Kryesor Ujitës Mat-Lezhë” nuk është realizuar sipas specifikimeve të projektit, kushteve të kontratës dhe në kundërshtim të Nenit 12 të Ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. *Më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### **3. Inspektoratit të Mbrojtjes së territorit Bashkia Korçë.**

Mbështetur në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 ”Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar, nenin 5/b; Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, nenin 15 ”Sanksionet”, Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe bazuar në nenin 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ***i rekomandoj Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Korçë*** që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënimin me gjobë për:

Mbikëqyrësin e punimeve, firmës “T” sh.p.k me përfaqësuese **znj. D.Q**, me numër licence MK 0919/7, pasi:

Në objektin “Kanali Kryesor Ujitës i Rezervuarit Gjanç zona Pulahe, Korçë”, është përfituar nga operatori ekonomik “B” sh.p.k, vlera e punimeve të pakryera **980,800 lekë pa t.v.sh**, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në kontratën e lidhur me OE fitues Nr.-, datë 27.04.2015, me vlerë të kontratës 49,928,949 lekë me t.v.sh. *Më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## **F. AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në referim të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 “Statusi i nëpunësit civil”, datë 13.05.2013 dhe kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe përgjegjësive individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet e mbajtura gjatë auditimit, vërejtjeve, komenteve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit;

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në

germën (c dhe ç) të nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i **rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative **dënim me gjobë** në raport me shkeljet e konstatuara, për punonjësit, si më poshtë:

**-Për Njësinë e Prokurimit: Znj. M.K Juriste, Z. G.S Jurist dhe Z. G. X, agronom (në 2015 Z. K.N, agronom).**

Në procedure e prokurimit me objekt “**Shpenzime mbrojtje bimësh & luftimi i parazitëve në bujqësi, vitet 2014, 2015**, janë konstatuar parregullsi e shkelje lidhur me përgatitjen e miratimit e dokumenteve të procedurës së prokurimit, si:

-Lidhur me përcaktimin e objektit të prokurimit, është klasifikuar kontratë shërbimi, pa ju referuar faktit se fondi i planifikuar do të përdoret kryesisht për blerjen e preparatit. Në piken 5 të nenit 3 të Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, përcaktohet: “*Kontrata publike, që ka si objekt mallra dhe shërbime, vlerësohet si “kontratë publike për shërbime”, nëse vlera e shërbimeve në kontratë tejkalon atë të mallrave në të njëjtën kontratë*”. Në rastin konkret, vlera e preparatit zë pjesën kryesore të vlerës së kontratës.

-Në DT mungon grafiku i detajuar për zhvillimin e aktiviteteve, shtrirja në kohë, brenda afateve 7 ditë kalendarike, duke mos zbatuar piken 1/c të kreut III, të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar.

-Lidhur me kapacitetin teknik është kërkuar Licencë për tregtimin me shumicë e pakicë të pesticideve, të vërtetuar nga QKL, duke mos dhënë sqarime pse është i domosdoshëm ky dokument, kur sipas dokumenteve të tenderit kemi të bëjmë me procedurë prokurimi shërbime. Mund të kërkohej licencë për përdorimin e këtyre preparateve, por jo për tregtim me shumicë e pakicë, pasi përjashton nga konkurimi operatorë ekonomik që kryejnë vetëm aktivitet shërbimi në këtë fushë.

-Nuk është argumentuar realizimi i shërbimit të kërkuar sipas objektit të kontratës me një numër të vogël punonjësish (15 punonjës) dhe për një afat kohor të shkurtër (brenda 7 ditëve kalendarike) etj. Kjo do të thotë se mesatarisht çdo ditë duhet dezinfektuar një sipërfaqe mesatarisht 1127 ha. Gjithashtu nuk është argumentuar pse janë të domosdoshëm 5 punonjës me arsim të lartë agronom/kimist.

**Për Grupin e punës, lidhur me përgatitjen e termave të referencës dhe përlllogaritja e fondit limit Znj. A.D Ing. IT, Z.T.O ekonomist dhe Z. B.Ç juriste.**

Në prokurimin me objekt “**Shërbim për mirëmbajtjen e sistemit BLU-BOX për vitet 2014-2016**”, janë konstatuar parregullsi e shkelje si:

-Shpenzimet për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit BLU-BOX, nuk janë ndarë në **Operacionale**, ku përfshihen shpenzimet për shërbimet e transmetimit të dhënave përmes GPRS, EDGE apo 3G përmes rrjetit GSM dhe të **mirëmbajtjes** që kanë të bëjnë me shërbime për mbajtjen e sistemeve operative të përditësuara, aplikim të patch-eve të nevojshme, ndërrimin e ndonjë pjese hardware, etj.

-Në Dokumentet elektronike të tenderit, lidhur me kohëzgjatjen e shërbimit, nuk ka përputhje me dokumentet shkresore. Kjo parregullsi çuar në mospërputhjen midis njoftimit të kontratës për zhvillimin e procedurës (pjesë e dokumenteve të tenderit) dhe njoftimit të kontratës së nënshkruar. Në tre vitet për kryerjen e procedurës me këtë objekt, janë konstatuar pagesa të pajustificuara, për periudha kohore që nuk është marrë shërbim.

**Për Grupin e punës për llogaritjen e fondit limit, përgatitjen e specifikimeve teknike, i përbërë nga: Z.A.G inxhinier, Z. S.P mjek veteriner dhe Z. L.K inxhinier ndërtimi.**

Në tenderin me objekt “**Blerje pajisje për shërbimin veterinar (motoçikleta, kaska, veshje, doreza, çanta)**”,

-Llogaritja e fondit limit, nuk është mbështetur në gjendjen reale të çmimeve të tregut. Çmimi real i tregut, për një tip motoçikletë me karakteristikat e kërkuara nga AK, është shumë më i ulët



se ai që është marrë nëpërmjet tre ofertave. Konkretisht për motoçikletën “Lifan tip 100-A” paraqitur në ofertën e fituesit, çmimi varion nga 980 -1050 euro (burimi- çmimet nga interneti). -grupit të punës, nuk ka argumentuar kërkesat për motoçikletat, të përshtatshme për transportin e dy personave; të përdoren nga shërbimi veterinar, për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për blegtorinë për fermerët në të gjithë territorin e R. Shqipërisë dhe të përdoren në rrugë rurale të shtruara me asfalt ose zhavorr dhe shpesh do të përdoren edhe në rrugë natyrore, me specifikimet teknike. Me motoçikletat sipas specifikimeve teknike të kërkuara, nuk mund të realizohet shërbimi i kërkuar mësipër.

**Grupi i punës për llogaritjen e fondit limit, përgatitjen e specifikimeve teknike, i përbërë nga Z.L.H. zooteknik, Znj. M.P zooteknike dhe Znj. E.P. zooteknike.**

Për procedurën me objekt **“Blerje kafshë të llojit gjedh për dëmshpërblimin e fermerëve të dëmtuar nga dermatozat nodular e gjedhit”**. Janë konstatuar shkelje e parregullsi në zbatimin e procedurave të prokurimit, lidhur me;

-për llogaritjen e vlerës së fondit limit, duke mos analizuar çmimet e tregut. Çmimi për kokë (mëshqerrë), ka qenë i lartë dhe nuk i përgjigjet çmimeve të tregut të vendit, bile edhe vetë çmimeve me të cilët OE “NF” shpk, shpallur fitues i tenderit, ka bërë shitjet gjatë vitit 2016. Në dokumentet e ofertës të OE “NF” shpk, për shitjet e gjësë së gjallë, rezultojnë çmime të shitjes së mëshqerrave (pa përcaktuar racën), për 138,096 lekë/krerë pa TVSH. Gjatë vitit 2014 OE “NF” shpk, ka importuar mëshqerra të racës xhers çmim 1,350 euro për kokë dhe rreth 1,563 euro/krerë ose rreth 218,900 lekë/krerë (me kurin 1 euro≈140 lekë).

Përdorimi i metodës së përlllogaritjes së fondit limit, duke marrë oferta nga operatorë ekonomik që ushtrojnë aktivitet në fushën e objektit të prokurimit, pa bërë një analizë të çmimit, nuk ka qenë i efektshëm dhe nuk ka pasqyruar gjendjen reale të tregut. Grupi i Auditimit të KLSH-së ka arritur në konkluzionin se çmimet e përdorur për llogaritjen e fondit limit kanë qenë të lartë, duke u bazuar edhe në një fakt tjetër: analiza e ofertave të paraqitura nga i njëjti operator ekonomik “NF” shpk, në dy momentet e procedurës; ofertat e paraqitur në studimin e tregut, për llogaritjen e fondit limit të kontratës dhe në fazën e konkurrimit. Konkretisht, oferta me nr.67 prot, date 16.12.2016 e paraqitur tek AK nga operatori OE “NF” shpk, pra vetëm 5 ditë para konkurrimit në tender, çmimi i ofruar për një mëshqerrë është 248,648 lekë pa TVSH, ndërsa në ofertën e paraqitur në tender, çmimi për mëshqerrë është 256,859.5 lekë, me një diferencë më tepër 8,211.5 lekë.

**Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave: Z.E F kryetar, Z.A L anëtar dhe Znj.E R anëtare.**

Për procedurën me objekt **“Blerje kafshë të llojit gjedh për dëmshpërblimin e fermerëve të dëmtuar nga dermatozat nodular e gjedhit”**. Janë konstatuar shkelje e parregullsi në zbatimin e procedurave të prokurimit, lidhur me;

a)Për të argumentuar kapacitetin teknik, është kërkuar dëshmi e kontratave të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 25% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të OE (1.11.2013-1.11.2016) shprehur në vlerë 62.5 milion lekë.

Për të argumentuar plotësimin e këtij kriteri specifik kualifikimi, OE “NF” shpk, ka paraqitur dokumentet: Fatura tatimore shitje të mallrave ushqimor si qumësht, kos, djathë kaçkavall, gjalpë i shkrirë, vaj ulliri etj, vlera e të cilave për vitet 2014, 2015 është 53,254,937 lekë (me TVSH). Vlera e gjësë gjallë, të shitur në tre vite është vetëm 24,611,226 lekë pa TVSH dhe 29,533,471 lekë me TVSH. Vendimi i KVO për të vlerësuar shitjen e qumështit, kosit, gjalpë, djathit apo vajit të ullirit etj, të ngjashme me objektin e prokurimit (blerje mëshqerra), nuk është i mbështetur në bazë ligjore. OE “NF” shpk nuk ka plotësuar këtë kriter të veçantë kualifikimi dhe duhet të ishte skualifikuar.

b)Siç rezulton nga dokumentet e paraqitur, OE nuk ka qenë i rregullt në përmbushjen e detyrimeve për energjinë elektrike, është debitor për fatura të pashlyera dhe është vendosur në rregull ligjor, vetëm nëpërmjet Aktmarrëveshjes date 27.04.2016, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale 505,047.92 lekë. Gjithashtu, shoqëria rezulton debitore edhe për

kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në vlerën 1,976,751 lekë, nga të cilat për vlerën 1,476,751 lekë ka lidhur aktmarrëveshje për pagesën e tyre me këste (Aktmarrëveshje me nr. Prot. 43075/1, date 23.06.2016, dhe për vlerën 500 mijë lekë, është në proces gjyqësor). Këto fakte nuk tregojnë mungesë qëndrueshmërie të aktivitetit ekonomiko-financiar të shoqërisë dhe neglizhencë (apo pamundësi), për plotësimin e detyrimeve ligjore ndaj punonjësve dhe shtetit, rivendosja e të cilave në shinat e ligjit, është bërë vetëm mbasi janë konstatuar nga hallkat shtetërore dhe janë vënë në rrugën e zgjidhjes nëpërmjet aktmarrëveshjeve dypalëshe.

c) Për gjendjen financiare, të ardhurat më të larta nga shitja kanë qenë maksimumi në vitin 2016, me rreth 68 milion lekë. Nisur nga ky tregues dhe gjendjen debitore më sipër, audituesit e KLSH-së, nuk janë të bindur se shoqëria mund të realizojë kontratën e blerjes së mallrave, aq më tepër brenda një periudhe relativisht të shkurtër, brenda 4 muajve kalendarik (968 krerë mëshqerra me specifikimet e kërkuara nga AK), me vlerë rreth 300 milion lekë me TVSH, pra kontratë me vlerë mbi kufirin e lartë monetar (neni 8, VKM nr.914, date 29.12.2014 i ndryshuar).

Për kualifikimin e operatorëve ekonomik me mangësi në dokumentacionin e ofertës të tyre, jo në përputhje me nenin 46 të LPP, duke mos zbatuar detyrat e përcaktuara në nenin 58 të VKM nr.914, date 29.12.2014 i ndryshuar, ka përgjegjësi komisioni i vlerësimit të ofertave.

#### **Për Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave: z. AV, znj.AE dhe znj.EM**

Për procedurën me objekt **“Rikonstruktion i Kanalit Ujitës, Grizhë-Koplik, Shkodër”**. Janë konstatuar shkelje e parregullsi në vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender, përkatësisht:

Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka gjykuar të arsyeshme të skualifikoj operatorët ekonomik si “B” sh.p.k, OE “B” sh.p.k, “KK” sh.p.k, “S” sh.p.k, kryesisht për mos paraqitjen e dokumentacionit bazë për mjetin motorik tip “Fadromë me goma”, si leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik dhe polica e sigurimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të BOE “S” sh.p.k & “DC” sh.p.k në sistemin elektronik dhe dosjen e noterizuar, konstatohet se edhe këtij bashkimi operatorësh ekonomik i mungon dokumentacioni bazë për mjetin motorik tip “Fadromë”. Përkatësisht BOE, për këtë mjet ka paraqitur vetëm kontratën e qerasë Nr.1665 datë 10.02.2015 nënshkruar nga “S” sh.p.k me firmën “G” dhe vërtetimin e zhdoganimit datë 27.11.2005.

OE “B” sh.p.k i renditur i dyti sipas vlerësimit të KVO me ofertë 47,054,060 lekë pa t.vsh, është skualifikuar për mosparaqitjen e dokumentacionit të Fadromës dhe paraqitjes vetëm të 2 vibratorëve dhe jo 3 copëve sa është kërkuar në DST. Ndërkohë nga verifikimi në sistem ky OE posedon 2 vibrator betoni dhe 1 kompaktor me vibrim. Ndërsa OE “S” sh.p.k i renditur i katërti me ofertë 53,890,165 lekë me tv.sh, është skualifikuar nga komisioni i shqyrtimit të ankesave vetëm për mosparaqitjen e dokumentacionit të Fadromës. Diferenca midis ofertës të OE “B” sh.p.k dhe BOE “S” sh.p.k & “D” sh.p.k është 7,743,526 lekë, ndërsa diferenca mis OE “S” sh.p.k dhe BOE “S” sh.p.k & “D” sh.p.k është 907,421 lekë. Paraqitja vetëm e vërtetimit të zhdoganimit për mjetin Fadromë nga të gjithë operatorët ekonomik mund të konsiderohet devijim i vogël dhe operatorët ekonomik duhet të ishin vlerësuar mbi këtë kriter. Komisioni i shqyrtimit të ankesave nuk ka bërë një trajtim të barabartë për vlerësimin e ofertuesëve pjesëmarrës në tender, në mospërputhje me Nenin 1, pika 2d dhe Neni 2, pika a dhe c, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, dhe Ligjin Nr. 182/2014 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, duke kualifikuar BOE “S” sh.p.k & “D” sh.p.k, ndërkohë që nuk posedon dokumentacionin për të cilën operatorët e tjerë ekonomik ofertues janë skualifikuar.

#### **Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave: z. LB Kryetar, z. LK anëtar dhe znj. EZ.**

Për procedurën me objekt **“Rehabilitimi i Kanalit VLF, pjesa e parë (progresivi 0-12595)”**. Janë konstatuar shkelje e parregullsi në vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender, përkatësisht:

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE fitues "N" sh.p.k & "N"sh.p.k & "H" sh.p.k, rezultoi se kjo BOE nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit.

Përkatësisht operatorët ekonomik të BOE fitues, së bashku nuk i posedojnë 10 ekskavatorë me zinxhir, kriteri i përcaktuar në DST. BOE "N" shpk, posedon 5 ekskavatorë me zinxhir, "H" sh.p.k posedon 2 ekskavator me zinxhir, ndërsa "N" sh.p.k posedon 1 ekskavator me zinxhir. Përsa më sipër BOE fitues "N" sh.p.k & "H" sh.p.k & "N"sh.p.k duhet të ishte skualifikuar nga KVO, për mosplotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me posedimin e makinerive. Ky veprim është në kundërshtim me Neni 46, Kualifikimi i ofertuesve, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "PËR PROKURIMIN PUBLIK", ku citohet "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme".

**Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave: z.LB Kryetar, z.LK anëtar dhe znj. EZ.**

Për procedurën me objekt "Rehabilitimi i Kanalit VLF, pjesa e dyte (progresivi 12595-22622)". Janë konstatuar shkelje e parregullsi në vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender, përkatësisht:

Nga auditimi i dokumentacionit të BOE fitues "Sh" sh.p.k & "F" sh.p.k & "G" sh.p.k, rezultoi se kjo BOE nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit.

Përkatësisht OE "Sh" sh.p.k dhe "F" sh.p.k i mungon vërtetimi nga organet Tatimore për xhiron vjetore të vitit 2015. Përsa më sipër BOE fitues "Sh" sh.p.k & "Fsh.p.k & "G" sh.p.k duhet të ishte skualifikuar nga KVO, për mosplotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me vërtetimet në organet tatimore. Ky veprim është në kundërshtim me Neni 46, Kualifikimi i ofertuesve, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "Për Prokurimin Publik", ku citohet "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme".

**Për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave: z. KJ Kryetar, z.LB, anëtar dhe znj. EZ.**

Për procedurën me objekt "Rehabilitimi i rrjetit të kanalit ujitës të rezervuarit Shishtavec". Janë konstatuar shkelje e parregullsi në vlerësimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në tender, përkatësisht:

Dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik fitues "B" sh.p.k, mbas shqyrtimit të dokumentacionit nga grupi i auditimit, u konstatua se këtij operatori ekonomik, i mungojnë disa dokumente për mjetet e mëposhtme:

-Kamionit me targe A...G, i mungojnë taksat dhe kolaudimi.

-Auto vinçit 5 ton i kanë skaduar taksat dhe kolaudimi dhjetor të vitit 2014, ndërkohë tenderi është zhvilluar në datë 26.02.2015.

-Autobetonieres i mungon kontrolli teknik dhe taksat.

-Ndërsa posedon vetëm 1 Tokmak mekanik për ngjeshje dherash (vibrator ngjeshës -Batipal) paraqitur me faturë 12 datë 09.03.2012, blere nga A M C, ndërkohë që në DST janë kërkuar 3 copë tokmak mekanik për ngjeshje dherash. Operatori ekonomik fitues "B" sh.p.k duhet të ishte skualifikuar nga KVO, për mosplotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me posedimin e makinerive, ku specifikohet se "makineritë vërtetohen nëpërmjet aktit të pronësisë, leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, taksa dhe policie sigurimi. Ky veprim është në kundërshtim me Neni 46, Kualifikimi i ofertuesve, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar "PËR PROKURIMIN PUBLIK", ku citohet "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme".

**Për Njësinë e Prokurimit: G.S M.K, E.B.** Për procedurën me objekt "Rehabilitimi i rrjetit të kanalit ujitës të rezervuarit Shishtavec". Janë konstatuar parregullsi përsa i përket vendosjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në lidhje me kapacitetin teknik, punë të ngjashme, ka

kërkuar vetëm dokumentacionin e nevojshëm vetëm për punët e realizuara për institucione shtetërore, por nuk ka specifikuar dokumentacionin që duhet të posedojnë ofertuesit kur paraqesin një punë të ngjashme të realizuar për llogari të subjekteve privat, në mënyrë që mos të bëhej shkak për interpretime nga ana e ofertuesëve.

Njësia e prokurimit ka vendosur kriteret e veçanta të kualifikimit në lidhje me makineritë, ku është specifikuar dokumentacioni i nevojshëm që duhet të posedojnë mjetet, ku është përcaktuar “*Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me ane të aktit të pronësisë. Ato të marra me qira të shoqërohen me kontratë qiraje (ose forme tjetër huaje) si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontrata e qirasë të përmbaje objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve. Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policen e sigurimit të mjeteve*”, por nuk janë kërkuar taksat vjetore të automjeteve, megjithëse është kërkuar certifikata e kontrollit teknik, leja e qarkullimit dhe policia e sigurimit. Ky fakt është bërë shkas për interpretime nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave gjatë procedurës së vlerësimit.

Të cilët kanë dhënë miratimin për ndryshimet thelbësorë gjatë zbatimit të projekteve të objekteve “Rehabilitimi i Kanalit VLF, pjesa e dyte (progresivi 12595-22622)” dhe “Kanali Kryesor Ujitës Mat-Lezhë”.

**Për Grupin e punës për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit: S.N ekonomiste, J.B ekonomiste dhe B.G (Eksperte e jashtme).**

Në prokurimin me objekt “**Ofrim shërbimi për organizimin e muajve të bujqësisë shqiptare për vitin 2014**”, janë konstatuar parregullsi e shkelje, si:

-Është bërë grupimi i mallrave e shërbimeve që nuk kanë karakteristika të përbashkëta, dhe llogaritja e vlerës është bërë me të njëjtin çmim për njësi, si: grupimi në të njëjtin zë, të materialeve promovuese postera, mjete me logo të Ministrisë dhe aktiviteti, marrja me qira e makinave, ose biçikletave lëvizëse, city-light etj, në sasinë 6000 copë, secili me çmimin 645 lekë.

-Për disa mallra apo shërbime, çmimet njësi janë të lartë dhe të paargumentuar, si: çmimi i një zarfi 400 lekë, të një ftese 400 lekë, shpenzimet për ekspertët e verës (ekspert të huaj, pa përcaktuar vendin nga do të vijnë të ftuarit) 172,150 lekë/personi, shpenzime transporti e montimi (?), numri i personave 400, me çmim 2,200 lekë për person, etj.

-Tarifa për marrjen me qira të ambienteve (1400 lekë/m<sup>2</sup>), është përcaktuar, për njohur kërkesat e AK, lidhur me kohën që do të mbahen me qira ambientet, apo bazën ligjore ku bazohet çmimi.

Përllogaritja e fondit limit, nëpërmjet marrjes së tre ofertave, nga OE që operojnë në këtë fushë, nuk ka shërbyer për njohjen reale të tregut, duke ndikuar negativisht në përcaktimin e madhësisë të fondit dhe në përdorimin e tij me efektivitet. Për shkeljet ka përgjegjësi grupi i punës, i cili nuk ka zbatuar detyrat e përcaktuara në VKM nr.1, date 10.01.20107 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *Më hollësisht është trajtuar në pikën II faqet 108-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

## **G. TË TJERA**

Në zbatim të nenit 287 germa dh) te Kodit të procedurës penale, pjesa e posaçme “*Pastrimi i produkteve të veprave penale*” si dhe referuar kreut V Strukturat përgjegjëse dhe mbikqyrëse për zbatimin e ligjit “ të Ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “ Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar me Ligjin 10 391 datë 03.03.2011) **i rekomandojmë Ministrisë së Bujqësisë** si subjekt që i nënshtrohet ligjit të parandalimit sipas germës f) neni 3 si Autoritet Shtetëror përgjegjës për Administrimin dhe shitjen e Pronës Publike, **ti drejtohet menjëherë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për verifikimin e subjektit “B” me përfaqësues ligjor A.P ,pasi:**

*-Në praktikën e dhënies me qera të sipërfaqes 123.58 HA në fshatin Çukë, Komuna Aliko, Qarku Vlorë, dhënë subjektit “BF” me përfaqësues ligjor A.P, konstatohet se më datë 13.12.2014*

subjekti i është drejtuar me një kërkesë Ministrit të Bujqësisë për marrjen me qera të tokës prone shtetërore me qëllim krijimin e një ferme blegtorale me investim 2.5 milion Euro.

Shoqëria kontraktuese nga auditimi i dokumentacionit ligjor, ky subjekt është reregjistruar në QKR në datë 10.07.2014 me datë themelimi 09.07.2014 pra 5 muaj aktivitet në fushën e blegtorisë me eksperiencë si biznes familjar(pa eksperiencë tjetër tregtare). Referuar pikës 8 germa b) të Kapitullit IV “ Procedurat që ndiqen nga BQTB-ja për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” të VKM –s 460 datë 22.05.2013, ofertat me qëllim kualifikimin e tyre duhet të përmbajnë dokumentacion për : Burimin e financimit të shprehur në vlerë që garantojnë investimet” .

Subjekti në fjalë ka paraqitur si burim financimi dokumenta bankare të llogarive personale të familjarëve (respektivisht babai dhe nëna) si dhe llogarinë e vetë personale të cilat paraqesin një shumë prej 2 milion \$. Në zbatim të nenit 287 germa dh) te Kodit të procedurës penale ,pjesa e posaçme “Pastrimi i produkteve të veprave penale” si dhe referuar kreut V Strukturat përgjegjëse dhe mbikëqyrëse për zbatimin e ligjit “ të Ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 “ Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar me Ligjin 10 391 datë 03.03.2011) sa më lartë Ministria e Bujqësisë si subjekt që i nënshtrohet ligjit të parandalimit sipas germës f) neni 3 si Autoritet Shtetëror përgjegjës për Administrimin dhe shitjen e Pronës Publike, duhej ti drejtohej Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave për verifikimin e subjektit në fjalë, referuar nenit 12 pika 1, Raportimi tek autoriteti përgjegjës; si dhe në zbatim të nenit 8 “Kategoritë e klientëve, ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar” pika.1 germa ç) “të marrin masa të arsyeshme për të kuptuar burimin e pasurisë dhe të fondeve të klientëve e të pronarëve përfitues.” Veprime këto që nuk janë kryer nga kjo Ministri para dhënies së kontratës subjektit BF, dhe e bëjnë përgjegjëse për mos zbatim të Ligjit të sipërcituar “ Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, më hollësisht është trajtuar në pikën I faqet 93-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit,

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**